TRUPAT E HUAJ NË PRODUKTET USHQIMORE

Material informues për konsumatorët

GJETËT NJË TRUP TË HUAJ NË USHQIMIN TUAJ?

Ja çfarë duhet të bëni

- Trupat e huaj në ushqime, si copëza plastike, metali, qelqi, gome, druri, guri ose materiale të tjera, nuk duhet të jenë pjesë e një produkti ushqimor. Prania e tyre mund të paraqesë rrezik për shëndetin dhe kërkon reagim të menjëhershëm.
- Ky material synon të udhëzojë konsumatorët mbi hapat që duhet të ndjekin nëse konstatojnë një trup të huaj në një produkt ushqimor ose nëse produkti që kanë blerë është objekt i një njoftimi zyrtar për tërheqje nga tregu.
- Veprimi i shpejtë ndihmon në mbrojtjen e shëndetit tuaj dhe kontribuon në identifikimin e produkteve të pasigurta, duke mbështetur autoritetet përgjegjëse në marrjen e masave për mbrojtjen e konsumatorëve.

Çfarë duhet të bëni?

1. Mos e konsumoni produktin

- Nëse vini re një trup të huaj në ushqim, ndaloni menjëherë konsumimin e tij.
- Mos u përpiqni të hiqni vetëm pjesën e dukshme dhe të konsumoni pjesën tjetër të produktit, pasi nuk mund të përjashtohet prania e trupave të tjerë të huaj.

2. Ruani produktin dhe paketimin

- Mos e hidhni produktin.
- Ruani:
    - paketimin origjinal;
    - emrin dhe markën e produktit;
    - numrin e lotit;
    - datën e skadencës ose "Afati minimal i përdorimit".
- Ky informacion është thelbësor për identifikimin e produktit dhe ndihmon autoritetet dhe operatorin ekonomik gjatë verifikimit të rastit.

3. Kontrolloni njoftimet zyrtare

- Nëse autoritetet kanë publikuar një njoftim për tërheqjen ose rikthimin e produktit nga tregu, krahasoni emrin e produktit, numrin e lotit dhe datën e skadencës me produktin që keni në shtëpi.
- Vetëm këto të dhëna konfirmojnë nëse produkti juaj është pjesë e njoftimit.

4. Raportoni rastin

- Nëse gjeni një trup të huaj në ushqim, informoni operatorin ekonomik nga i cili është blerë produkti ose autoritetin përgjegjës për sigurinë ushqimore (Autoritetin Kombëtar të Ushqimit – AKU).
- Raportimi juaj ndihmon në identifikimin e produkteve të tjera potencialisht të prekura dhe lehtëson marrjen në kohë të masave për mbrojtjen e konsumatorëve.

5. Kthejeni produktin në pikën e shitjes

- Në rastet kur produkti është objekt i një njoftimi zyrtar për tërheqje nga tregu, ndiqni udhëzimet e publikuara nga operatori ekonomik ose autoritetet përgjegjëse.
- Në shumë raste, produkti mund të kthehet në pikën e shitjes dhe konsumatori përfiton rimbursim ose zëvendësim të tij.

6. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme

- Nëse produkti është konsumuar dhe dyshoni se është gëlltitur një trup i huaj ose shfaqen simptoma si:
    - dhimbje gjatë gëlltitjes;
    - dhimbje të forta në gojë, fyt ose bark;
    - gjakderdhje;
    - të vjella;
    - ose shqetësime të tjera të pazakonta,
- drejtohuni menjëherë pranë shërbimit shëndetësor.

Pse është i rëndësishëm raportimi?

- Çdo raportim ndihmon autoritetet të vlerësojnë nëse problemi lidhet me një produkt të vetëm apo me një seri produktesh.
- Nëse konfirmohet rreziku, mund të ndërmerren masa si tërheqja ose rikthimi i produktit nga tregu, duke mbrojtur edhe konsumatorët e tjerë.

MBANI MEND

Nëse konstatoni një trup të huaj në një produkt ushqimor:

- ✔ Mos e konsumoni produktin.
- ✔ Ruani produktin dhe paketimin origjinal.
- ✔ Ruani emrin, numrin e lotit dhe datën e skadencës.
- ✔ Kontrolloni njoftimet zyrtare të autoriteteve.
- ✔ Raportoni rastin tek operatori ekonomik ose AKU.
- ✔ Kërkoni ndihmë mjekësore nëse dyshoni për dëmtim pas konsumimit.

Mos e neglizhoni praninë e një trupi të huaj në ushqim.

Reagimi i shpejtë mbron shëndetin tuaj dhe ndihmon në rritjen e sigurisë ushqimore për të gjithë konsumatorët.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
Tel.: 0800 7575
E-mail: info@aku.gov.al
Website: www.aku.gov.al

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
Tel.: 042 378 897
E-mail: ishp@shendetesia.gov.al
Website: www.ishp.gov.al

Referencat

1. Food Safety Authority of Ireland. Food Alerts and Recalls. Dublin: FSAI. Available from: https://www.fsai.ie/news-and-alerts/food-alerts
2. RappelConso. Rappels de produits – Risque de présence de corps étranger. Gouvernement Français. Available from: https://rappel.conso.gouv.fr
3. U.S. Food and Drug Administration. CPG Sec. 555.425: Foods, Adulteration Involving Hard or Sharp Foreign Objects. Silver Spring (MD): FDA.
4. Payne K, et al. Detection and prevention of foreign material in food: A review. *Foods.* 2023;12.